



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 842/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Laziç dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, morri këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec

Arsyetim

Me datën 12.11.2013, AAK-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, në kuti të votimit ekziston mospërputhja e procesverbalit me listat e votimit, prandaj i njëjti pretendim ankimorë është kërkesë e përgjithshme nga shumica e kandidatëve që janë në listën e AAK-së .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 të LZP-së parashihet se : *“Mund të apelohe vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

Me ankesën e parashtruar nga AAK-ja pretendohet se kanë ndodhur pa rregullsi dhe mundësi të keqpërdorimit dhe manipulimit me listat e votuesve, pasi që ekziston mospërputhje me procesverbalin, mirëpo një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i paqartë për tu vërtetuar .

PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, pasi që mungojnë provat me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 842/2013 më datën 12.11.2013



**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**

Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.